



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex Officio

Rasti nr. 346/2019

në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit përkitazi me mbrojtjen nga dhuna në familje për të drejtën në jetë, që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

Për:

- Z. Ramush Haradinaj, kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës
- Z. Rashit Qalaj, drejtor i Policisë së Kosovës
- Z. Uran Ismaili, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë
- Z. Skender Çoçaj, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- Z. Bahri Hyseni, kryesues i Këshillit Prokurorial
- Z. Shpend Ahmeti, kyetar i Komunës së Prishtinës
- Z. Basri Kastrati, menaxher i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

Kopje:

Znj. Duda Balje, kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Prishtinë, më 31 korrik 2019

Qëllimi i Raportit

1. Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut është thelbësore dhe shumë e rëndësishme për një përgjigje efektive në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Republikën e Kosovës. Përkundër faktit se Republika e Kosovës ka bërë shumë përpertime në krijimin e mekanizmave reagues ndaj rasteve të dhunës në familje, ka ende aspekte që kërkojnë vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse, përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën për jetë. Viktimat e dhunës në familje vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme, sidomos nga mosfunksionimi i autoriteteve të krijuara enkas për parandalimin e kësaj dukurie shqetësuese, e cila në shumë raste po përfundon me fatalitet. Këto sfida janë të ndërlidhura edhe me barriera të ndryshme, me neglizhencë të autoriteteve, me paragjykimet dhe stereotipat, me pabarazinë gjinore, si dhe me prezencën e stigmës e të diskriminimit në institucionet e ndryshme.
2. Ky Raport, së pari, ka për qëllim vlerësimin e aplikimit të parimeve kryesore të detyrimeve pozitive të shtetit përkitazi me të drejtën për jetë, lidhur me vrasjen e trefishtë e cila ndodhi më 22 prill 2019, në lagjen Dardania në Prishtinë, me ç' rast u raportua se një burrë ka vvarë me armë zjarri gruan e tij, gruan e djalit e pastaj edhe veten. Mediat raportuan se burri që kreu vrasjen ka qenë i sëmurë psikik, ndërsa familjarët e tij ishin të rrezikuar edhe më herët nga sjelljet e dhunshme¹. Së dyti, ky Raport ka për qëllim ta vlerësojë realizimin efektiv të të drejtave të personave/viktima të dhunës në familje në Kosovë në raport me qasjen për kujdes dhe trajtim, duke u ndalur në veçanti tek diskriminimi, pabarazia, dështimi i autoriteteve për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës në familje, si dhe në detyrimet e shtetit për t'i mbrojtur jetët e qytetarëve.
3. Këto të drejta, të mbrojtura me Kushtetutë dhe me instrumente ndërkombëtare, realizohen në praktikë përmes ligjeve, përmes politikave dhe strategjive, implementimin e të cilave do ta analizojë ky Raport dhe në fund do të dalë me konstatime dhe me rekomandime lidhur me përmirësimin e gjendjes sa i përket personave/viktima të dhunës në familje, nga perspektiva e të drejtave të njeriut, në mënyrë që raste të tilla të dhunës në familje të mos përsëriten në të ardhmen.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: *“Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”*; kurse në paragrafin 3 përcakton: *“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*
5. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

¹ <https://indeksonline.net/vrasja-e-trefishte-ne-prishtine-çfare-e-shtyu-61-vjecarin-te-qelloi-per-vdekje-gruan-dhe-nusen-e-djalit/>

- “Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjnë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).
- “Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).
- “T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).
- “Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).
- “Të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).
- “T’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij Raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

Përshkrimi i çështjes

6. Ky Raport është iniciuar sipas detyrës zyrtare duke u bazuar në raportimet e mediave të shkruara dhe atyre elektronike, të cilat raportuan se më 22 prill 2019, në lagjen Dardania në Prishtinë, kryefamiljari Hasan Krasniqi (më tutje H. K.) vrau me armë zjarri bashkëshorten e tij Hysnije Krasniqi, gruan e djalit Remzije Krasniqi, e pastaj e vrau veten; dhe raporti bazohet ekskluzivisht në të gjeturat nga hetimet e realizuara *Ex Officio* lidhur me këtë çështje.

Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

7. Më 30 prill 2019, përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) vendosën kontaktet e nevojshme me zyrtarët përgjegjës të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK), nga të cilët kërkuan informacione lidhur me trajtimin psikiatrik të pacientit H. K. dhe morën informacione se personi H. K., nuk është trajtuar asnjëherë në IPFK, por ata kishin informata jozyrtare se i njëjti kishte probleme psikike, pasi që dyshohej se vuante nga sëmundja “Syndroma Pschycoticum” dhe mjekohej te një psikiatër privat.
8. Më 2 maj 2019, përfaqësuesi i IAP-së bisedoi me mbrojtësin e viktimave i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (më tutje: ZMNV) në Prishtinë, me të cilin diskutoi

lidhur me zhvillimet e ngjarjes në çështjen e viktimës Hysnije Krasniqi. Ai e njoftoi se vetë e kishte menaxhuar këtë rast të dhunës në familje gjatë vitit 2017/18, duke theksuar se gjykata kishte lëshuar urdhër mbrojtës (lënda C.nr.2006/17) për 12 muaj ndaj palës së mbrojtur Hysnije Krasniqi dhe nga ana tjetër prokurori i rastit kishte filluar procedurën penale kundër të akuzuarit H. K. për veprat penale “Sulm” dhe “Armëmbajtje pa leje”, prandaj lënda kishte kaluar në gjykatë për shqyrtim dhe vendosje. Mbrojtësi i viktimave i ZMNV-së theksoi se, pasi kishte kaluar afati 12 muajsh, nuk ishte vazhduar urdhër mbrojtja dhe bashkëshortët kishin filluar të bashkëjetonin, por fatkeqësisht ishin përsëritur situatat e konfliktit brenda familjes dhe kishte ardhur deri te vrasja e trefishtë.

9. Më 7 maj 2019, përfaqësuesit e IAP-së u takuan me ushtruesin e detyrës së drejtorit të Qendrës për Punë Sociale (QPS) numër 1 në Prishtinë, nga i cili kërkuan informacione lidhur me trajtimin psiko-social të kryesit të dhunës në familje (personit H. K.), apo palës së mbrojtur - viktimë e dhunës në familje (Hysnije Krasniqi). Ai e njoftoi se QPS-ja nr. 1, në Prishtinë ka kompetencë lëndore dhe territoriale t’i trajtojë rastet e dhunës në familje të lagjes Dardania, në të cilën kanë banuar familja Krasniqi. Por bazuar në regjistrat e QPS-së për vitet 2016, 2017 dhe 2018, shihej qartë se bashkëshortëve Krasniqi nuk u janë ofruar fare shërbime psiko-sociale nga kjo QPS. Ai e njoftoi se QPS-të kryesisht i trajtojnë fëmijët - viktima të dhunës në familje dhe theksoi se QPS-ja nr. 1 ka mungesë të psikologëve, pasi që nga viti 1999 e deri më tash kjo QPS nuk e ka të punësuar asnjë psikolog, pavarësisht nevojave të shumta për prezencën e psikologut në QPS.
10. Në të njëjtën ditë, përfaqësuesit e IAP-së u takuan me mbikëqyrësin e ZMNV-ve dhe me menaxherin e rastit Krasniqi nga ZMNV-ja në Prishtinë, me të cilët biseduan lidhur me ecurinë e rastit të palës së mbrojtur Hysnije Krasniqi. Ata njoftuan se bashkëshortët Krasniqi kishin mosmarrëveshje që nga viti 2013 dhe, si pasojë e kësaj, nga gushti i vitit 2016, znj. Krasniqi ishte larguar nga banesa e bashkëshortit H. K. dhe banonte te fëmijët e saj të cilët ishin larguar nga banesa e H.K, si pasojë e dhunës së tij shumë vite më herët. Por sipas tyre, rastet nuk ishin raportuar te organet shtetërore (në polici apo diku tjetër). Ata deklaruan se rasti i dhunës në familje, i cili ishte trajtuar nga ZMNV-ja e Prishtinës, kishte ndodhur më 6 gusht 2017, rreth orës 20:30, kur Hysnije Krasniqi kishte shkuar te bashkëshorti i saj H. K. për t’u marrë vesh lidhur me çështjen e banimit dhe, gjatë asaj kohe, viktima kishte pësuar dhunë fizike dhe psikike nga H. K., prandaj rastin e kishte paraqitur në Stacionin Policor “Jugu”, më 7 gusht 2017, në ora 3:00 të mëngjesit dhe ishte intervistuar nga hetuesja policore kompetente (rasti nr. 2017-AD-2252, datë 7 gusht 2017). Ata sqaruan se në ditën e njëjtë, mbrojtësi i viktimave i ZMNV-së në Prishtinë kishte parashtruar *Kërkesë për Shqiptimin e Urdhër Mbrojtjes* në Gjykatën Themelore në Prishtinë (më tutje: GjThP) dhe, më 14 gusht 2018, GjThP-ja kishte nxjerrë Aktvendimin C.nr.2006/17, me të cilin kishte caktuar *Urdhrin për Mbrojtje*, duke ia ndaluar kryesit të dhunës H. K. që të mos u afrohej në distancën prej 50 metrash palës së mbrojtur - viktimës dhe fëmijëve të saj. Ata theksuan se personi H. K., kishte parashtruar ankesë ndaj Aktvendimit C.nr.2006/17, i datës 14 gusht 2018, dhe lënda kishte kaluar për shqyrtim dhe vendosje në Gjykatën e Apelit të Kosovës (GjA), e cila, me Aktvendimin Ac.nr.3912/17, i datës 12 shtator 2017, kishte aprovuar pjesërisht ankesën e personit H.

K., dhe pjesërisht e kishte prishur Aktvendimin C.nr.2006/17, i datës 14 gusht 2018, në pjesën ku kishte të bënte me urdhrin mbrojtës ndaj fëmijëve, prandaj për këtë pjesë rastin e kishte kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Më 25 shtator 2018, GjThP-ja, në procedurë të rishqyrtimit (duke vepruar sipas Aktvendimit Ac.nr.3912/17, i datës 12 shtator 2017), kishte nxjerrë Aktvendimin C.nr.2448/17, me të cilin e kishte konstatuar si të tërhequr pjesërisht kërkesën e palës së mbrojtur Hysnije Krasniqi lidhur me *Urdhër Mbrojtjen* ndaj djemve të saj, me arsyetimin se pala e mbrojtur e ka tërhequr kërkesën dhe njëjtë ka vepruar edhe mbrojtësi i viktimave. Gjatë bashkëbisedimit, ata deklaruan se, gjatë vitit 2018, ZMNV-ja në Prishtinë ka mbrojtur 400 viktimë dhe ka marrë pjesë në 2250 seanca gjyqësore, duke theksuar se aktualisht kanë vetëm 4 mbrojtës të viktimave nga 6 sa ishin me herët. Sipas tyre, ZMNV-ja në Prishtinë ka nevojë edhe për dy mbrojtës të viktimave, duke theksuar se gjatë punës së tyre hasin në vështirësi, sidomos te strehimi i viktimave të dhunës (gra) me fëmijë meshkuj mbi moshën 12 vjeç (të cilët nuk lejohen të qëndrojnë në strehimore), si dhe në largimin e dhunuesve nga familja e viktimës kur bashkëshortët nuk kanë banesa tjera, duke nënvizuar se deri tash nuk ka strehimore për kryesit e dhunës në familje, por vetëm për viktimat e dhunës.

11. Në po të njëjtën ditë, përfaqësuesit e IAP-së u takuan me administratorin e GjThP-së dhe me zyrtarët e tjerë përgjegjës të kësaj gjykate, nga të cilët kërkuan informacione lidhur me procedurat penale ndaj të akuzuarit H. K., të zhvilluara në këtë gjykatë përgjatë viteve. Ata i njoftuan se nga shënimet e Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve rezulton se ndaj të akuzuarit H. K. janë zhvilluar tri procedura penale: P.nr.2487/08, lëndë e arkivuar; P.nr.4306/15, lëndë në ekzekutim dhe P.nr.5849/17, lëndë aktive. Përfaqësuesit e IAP-së u takuan me gjykatësin e rastit P.nr.5849/17 (lëndë aktive), me të cilin biseduan lidhur me lëndën P.nr.5849/17. Ai i njoftoi se lënda P.nr.5849/17 është aktive dhe e njëjta ka të bëjë me rastin e dhunës në familje (sulm dhe armëmbajtje pa leje). Ai sqaroi se prokurorja e rastit, më 11 dhjetor 2017, kishte ngrehur aktakuzë ndaj të pandehurit H. K. dhe lënda kishte kaluar në gjykatë dhe, deri më 7 dhjetor 2018, ishte te gjyqtari i procedurës paraprake, duke theksuar se pas 7 dhjetorit 2018, lënda P.nr.5849/17 i ishte caktua atij në punë dhe ai kishte planifikuar të caktonte seancë gjyqësore për datën 15 maj 2019, por sipas tij, ftesat akoma nuk u ishin dërguar palëve deri në momentin kur ndodhi vrasja. Ai pranoi se në këtë lëndë penale nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim procedural nga ana e gjykatës në kuptim të mbajtjes së seancave gjyqësore dhe u arsyetua për vonesën duke theksuar se vetëm ai ka mbi 1000 raste/lëndë në punë.
12. Tutje, në ditën e njëjtë, përfaqësuesit e IAP-së u takuan me hetuesen përkatëse policore dhe me shefin e hetimeve i Stacionit Policor “Jugu” në Prishtinë, me të cilët biseduan lidhur me rastin e intervistimit të Hysnije Krasniqit, viktimë e dhunës në familje nga i dyshuari H.K., intervistuar në polici më 7 gusht 2017. Hetuesja policore konfirmoi hetimin e këtij rasti nga ana e saj (rasti nr. 2017-AD-2252), por deklaroi se nuk i kujtohen shumë detajet e kësaj ngjarjeje, meqenëse ka kaluar një periudhë e gjatë kohore, por shtoi se është e sigurt se nuk kishte raportime lidhur me raste tjera të dhunës në familje nga ana e H. K., qoftë para apo pas kësaj periudhe. Lidhur me të kaluarën kriminale të H. K., deklaroi se nuk ka njohuri për rastet e mëhershme, por megjithatë duhet të hulumtohet në

Sistemin Informativ Policor të Kosovës (SIPK). Në pyetjen e përfaqësuesve të IAP-së se a ishte njoftuar QPS-ja lidhur me trajtimin psiko-social të viktimës apo të kryesit të dhunës në familje, ata u përgjigjën se për rastet e dhunës në familje zakonisht e njoftojnë QPS-në në cilësi të organit të kujdestarisë dhe kjo ndodh kryesisht për rastet kur ka fëmijë - viktimë të dhunës në familje.

13. Më 8 maj 2019, përfaqësuesi i IAP-së i dërgoi shkresë komandantes së Stacionit Policor “Jugu” në Prishtinë, nga e cila kërkoj informacione relevante përkitazi me të kaluarën kriminale (bazuar në shënimet e databazës policore/SIPK, përkitazi me dhunën në familje) për personin H. K. dhe një raport informues në kuptim të përshkrimit të rrethanave të ngjarjes së 22 prillit 2019, që ndodhi në lagjen Dardania në Prishtinë, si pasojë e së cilës mbetën të vrarë tre persona.
14. Më 10 maj 2019, IAP-ja siguroi shkresa të ndryshme nga familjarët e H. K., prej të cilave shihej qartë se H. K. ishte diagnostikuar me sëmundjen e kodifikuar F-22, si dhe i njëjti në periudha të ndryshme kohore e vizitonte (vizita ambulatorë) psikiatrin dhe trajtohej me medikamente anti-psikotike (Risperidon² tbl.) dhe anksiolitike (Xanax³ tbl.). Nga shkresat e pranuar, IAP-ja gjeti se H. K., në vitin 2008, e kishte sulmuar njërin nga familjarët e tij lidhur me pronën dhe i kishte shkaktuar lëndime trupore, prandaj Gjykata Komunale në Prishtinë e kishte dënuar H. K. me Urdhër Ndëshkimor (shih lëndën P.nr. 2487/2008) dhe po ashtu, në vitin 2015, e njëjta gjykatë ndaj tij kishte shqiptuar Urdhër Ndëshkimor për veprën penale *Shpërdorim i pasurisë së huaj* (shih lëndën P.nr.4306/15).
15. Më 13 maj 2019, komandantja e Stacionit Policor “Jugu” në Prishtinë i dërgoi shkresë përfaqësuesit të IAP-së bashkë me përgjigjet relevante përkitazi me të kaluarën kriminale për personin H. K., si dhe përshkrimin e rrethanave dhe ecurinë e procedurës për ngjarjen tragjike të datës 22 prillit 2019. Përmes përgjigjeve të dërguara, ata sqaruan se sipas SIPK-ut, personi H. K. ishte i përfshirë në dy raste të ndryshme kriminale, si person i dyshimtë për raste të dhunës në familje (*rasti i parë, me numër 2017-AD-2252, viktimë bashkëshortja e H. K.; dhe rasti i dytë me numër 2019 AD 0951, vrasja e trefishtë*) dhe në dy raste tjera ku personi H. K. kishte problemet me familjarë, por këto raste, sipas policisë, nuk ishin shënjuar me shenjë “dhunë në familje” (*rasti nr.2008-AC-1104⁴, viktimë e dhunës ishte vëllai i H. K. dhe rasti nr. 2003-AC-428⁵, viktimë ishte djali i H. K. dhe rasti ishte mbyllur në polici*). Lidhur me gjendjen shëndetësore të personit H. K., në përgjigjen dërguar IAP-së nga policia thuhet: “*Në bazë të intervistave nga familjarët e viktimave kemi kuptuar se H.K., ka pasur probleme shëndetësore që disa vite, pasi që fillimisht kishte probleme me sheqer, kishte probleme me shikimin dhe kohët e fundit*

² Risperidon Alkaloid-i i përket grupit të barnave të quajtura “anti-psikotik”.

³ Xanax është një qetësues që përmban si substancë aktive alprazolamin që përdoren kryesisht për trajtimin e ankthit të theksuar dhe ankthit të shoqëruar me depresion.

⁴ Me datë 8.8.2008 është iniciuar rasti “Rrahje-lëndim trupor” me numër 2008-AC-1104 në Stacionin Policor të Veriut, i cili rast është dorëzuar në PP. Komunale, më datën 22 gusht 2008, me kallëzim penal kundër Hasan Sadri Krasniqi, me ç’ rast viktimë e dhunës ishte vëllai i H. K., dhe lidhur me këtë rast, Gjykata Komunale në Prishtinë kishte nxjerrë aktgjykim me Urdhër Ndëshkimor me dënim prej 200 eurosh.

⁵ Rasti 2003-AC-428, iniciuar më 21 prill 2003, për veprën penale “**Kërcënim me armë**”, ndodhur në fshatin Grashticë, ku sipas të dhënave, viktimë ishte A. Krasniqi, djali i H. K., dhe rasti ishte mbyllur më datën 31 maj 2003, në kuadër të Stacionit Policor.

kishte probleme psikike dhe kemi siguruar raporte mjekësore nga të cilat rezulton se H.K., është trajtuar në mënyrë ambulatorie ne Klinikën e Psikiatrisë ne Prishtinë. Në bazë të kërkesës se policisë drejtuar Klinikës së Psikiatrisë që të sigurohet dosja mjekësore për viktimat e rastit, kemi pranuar një raport informues nga Klinika e Psikiatrisë në të cilin nuk rezulton se janë trajtuar në mënyrë hospitalore e po ashtu nuk figurojnë se kane pasur vizita ambulatorie ne këtë klinik (si pasojë e mungesës se evidencave përmes sistemit informativ shëndetësor). Sipas raportit të lëshuar nga Klinika e Psikiatrisë është e mundur që në disa raste pacientet të mos jenë të vëmendshëm apo edhe e bëjnë me qëllim të shmangën nga protokollimi i raporteve mjekësore dhe për këtë nuk kanë mekanizma të forta të detyrimit për evidentim.”

Baza ligjore

16. Neni 21, paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: *Kushtetuta*) përcaktojnë si në vijim: “*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë, Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.*”
17. Neni 22 i Kushtetutës përcakton: “*Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike*” kurse neni 23 përcakton: “*Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.*”
18. Neni 25, paragrafi 1, i Kushtetutës përcakton si në vijim:
“*Secili individ gëzon të drejtën për jetën [...]*”;
ndërsa neni 26 përcakton:
“*Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj [...]*”
19. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 29, paragrafi 1, përcakton: “*Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente si në vijim:*
- *Pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale [...];*
 - *Për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë, [...]*”;
- kurse neni 53 përcakton:
“*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*”

20. Kushtetuta i bënë drejtpërdrejt të zbatueshme në rendin ligjor të Kosovës një numër të instrumenteve e marrëveshjeve ndërkombëtare nga fusha e të drejtave të njeriut. Aty është përcaktuar që këto akte *zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike, ndër to është edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.*
21. Neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (4 nëntor 1950) (në tekstin e mëtejshëm: *Konventa*) përcakton:
- “E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj [...]”; ndërsa neni 5, paragrafi 1, i Konventës përcakton: “Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj [...]”*
22. Neni 1, paragrafi 1, i Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton:
- “Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktimë të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara”, ndërsa paragrafi 2 vazhdon tutje: “Ky ligj, po ashtu, ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.”*
23. Neni 4, paragrafi 1, i Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton:
- “Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial, mund të shqiptohet kryesisht të dhunës në familje në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese, me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme të kryerësit apo nëse ekziston rrezik i përsëritjes së dhunës në familje”; kurse neni 7, paragrafi 1, përcakton: “Masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, i shqiptohet personit që ka kryer dhunë ndaj anëtarit të familjes me të cilin jeton në banesë, shtëpi apo ndonjë hapësirë tjetër banimi, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.”*
24. Neni 17, paragrafi 2, i Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton:
- “Vendimi për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente ekzekutohet menjëherë me vendim përkatës, i shqiptuar nga Gjykata kompetente dhe i`u dërgohet menjëherë kryerësit të dhunës në familje Policisë së Kosovës, qendrave për punë sociale, si dhe palëve të tjera në procedurë”; ndërsa neni 27 i këtij Ligji përcakton: “Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me: Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit dhe me atë të Arsimit, është përgjegjëse për mbështetjen dhe për ngritjen e strukturave ndihmëse dhe të infrastrukturës së nevojshme, që shërben për mbështetjen dhe për plotësimin e nevojave të personave ndaj të cilëve është ushtruar dhuna në familje, përfshirë këtu asistencën sociale dhe shërbimet mjekësore, në pajtim me legjislacionin në fuqi.”*
25. Neni 1, paragrafi 3, i Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare përcakton:
- “Person në nevojë nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së*

Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak të [...] sëmundjes mendore [...].”

26. Neni 13, paragrafi 2, i Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare përcakton: “Nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se personit të rrezikuar i mungon zotësia për të vepruar në emër të vet dhe se është e nevojshme për ta mbrojtur të rriturin nga rreziku serioz, Qendra për Punë Sociale duhet të paraqesë pranë gjykatës kërkesën për një urdhër kujdestarie”; kurse paragrafi 4 përcakton: “Një urdhër i tillë specifikon hapat që Qendra për Punë Sociale është kompetent t’i ndër marrë në mënyrë që të mbrojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e personit për të cilin jepet urdhëri. Kompetencat që i ka gjykata në dispozicion janë:
- a. Mbikëqyrja e rrethanave të jetesës të të rriturit të rrezikuar nga ana e një profesionisti të caktuar nga Qendra për Punë Sociale për këtë qëllim, gjersa ai/ajo qëndron në shtëpinë e tij;
 - b. Urdhëresa për Qendra për Punë Sociale për të vendosur të rriturin, i cili mendërisht nuk është i aftë për t’u kujdesur për veten në një objekt të përshtatshëm rezidencial [...].”
27. Neni 13, paragrafi 5, i Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare përcakton: “Personi i cili është subjekt i një urdhri kujdestarie nuk mund të mbahet asesi në një institucion ndëshkimit”; kurse paragrafi 6 përcakton: “Nëse është e nevojshme, gjykatat mund të urdhërojnë Shërbimin Policor të Kosovës që ta ndihmojë Qendrën për Punë Sociale në zbatimin e urdhrit të kujdestarisë.”
28. Neni 75 i Ligjit nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore përcakton: “Sipas rregullave të kësaj procedure gjykata me aktvendim vendosë për mbajtjen e personit të sëmurë mendërisht (psikik) në institucionin shëndetësor, kur për shkak të natyrës së sëmundjes është e domosdoshme që personi i këtillë të kufizohet në lirinë e lëvizjes dhe të komunikimit me njerëzit jashtë institucionit në fjalë.”
29. Neni 4, paragrafi 1, i Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi përcakton: “Zbatimi i këtij ligji do të bëhet duke respektuar dinjitetin, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, që garantohen me Kushtetutë, dhe zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës”; ndërsa paragrafi 5 i po këtij neni përcakton: “Të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetar, banorëve, dhe shfrytëzuesve të tjerë të shërbimeve shëndetësore në kujdesin shëndetësor rregullohen me Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor.”
30. Neni 1 i Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Shëndetin Mendor) përcakton: “Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen me të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore.” Kurse neni 5, paragrafi 1, përcakton parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor ndër të cilat janë:

1.1. "Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime mendore, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.

1.2. Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullim mendor në një ambient sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjen nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social.

1.3. Krijimi i lehtësirave përmes programeve dhe projekteve të cilat implementohen nga organet kompetente për këta persona dhe familjet e tyre me qëllim të përfshirjes së tyre në jetën shoqërore.

1.4. Ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime mendore nga **ekipe multidisiplinare** që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit [...]."

31. Neni 9, paragrafi 1, i Ligjit për Shëndetin Mendor përcakton: "Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar i personave me çrregullime mendore është e ndaluar, përveç rasteve të parashikuara me dispozitat ligjore në fuqi. Në raste të veçanta kjo **masë mund të propozohet me kërkesë të komisionit psikiatriko-ligjor**. Vendimi përkatës merret nga gjykata, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi."
32. Neni 5, paragrafi 1, i Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi përcakton: "Kujdesi shëndetësor zbatohet duke u udhëhequr nga parimet themelore." Ndërsa paragrafi 1.2 përcakton: "Gjithë-përfshirja dhe jo diskriminimi: standarde të barabarta në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe banorët duke siguruar standardet gjatë përmbushjes së kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe sigurim i kujdesit shëndetësor pa diskriminim në bazë të gjinisë, kombit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike, gjendjes sociale, orientimit seksual, shkallës së aftësive fizike dhe mendore, statusit familjar dhe moshës." Paragrafi 2 i nenit 52 të këtij Ligji përcakton: "Institucioni shëndetësor nga paragrafi 1 i këtij neni është përgjegjës për grumbullimin, ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, sigurimin e qasjes së lehtë në të dhëna, mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e të dhënave nga keqpërdorimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi."; dhe: "Profesionisti shëndetësor dhe institucioni shëndetësor duhet të raportojnë për shërbimet e tyre [...] duke siguruar fshehtësinë profesionale⁶, në pajtim me ligjin."
33. Neni 4, paragrafi 1, i Ligjit nr. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor përcakton: "Çdo qytetar ka të drejtë, për kujdes shëndetësor që është i kushtëzuar me gjendjen e tij të shëndetit. Kujdesi shëndetësor duhet të jetë adekuat, me qasje në vazhdimësi për të gjithë dhe pa diskriminim." Kurse paragrafi 5 i këtij neni përcakton: "**Ofrimi i shërbimeve është pa asnjë diskriminim**, atëherë kur gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore qytetarët nuk janë të diskriminuar në bazë të pozitës së tyre shoqërore, pikëpamjeve politike, prejardhjes, kombësisë, religjionit, gjinisë,

⁶ Ligji nr. 04/L-125, neni 3 (Përkufizimet), paragrafi 1.33: **Fshehtësia profesionale** - ruajtja e të dhënave për gjendjen shëndetësore të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore nga qasja në to prej personave të paautorizuar.

preferencave seksuale, moshës, gjendjes martesore, paaftësisë trupore ose mendore, kualifikimit ose mbi çfarëdo baze tjetër [...].”

34. Neni 6, paragrafi 1, i Ligjit nr. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor përcakton: **“Gjatë trajtimit mjekësor duhet të respektohen: dinjiteti, jeta private, integriteti personal dhe bindjet religjioze të qytetarit.”** Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton: *“Në rast se dispozitat e këtij Ligji nuk përcaktojnë ndryshe, pa pëlqimin e qytetarit, mund të kryhen vetëm intervenimet e domosdoshme të trajtimit mjekësor.”*
35. Neni 9, paragrafi 1, i Ligjit nr. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor përcakton: *“Qytetari ka të drejtë që të pranojë informatën e plotë, në një formular individual.”* Ndërsa paragrafi 2 përcakton: *“Qytetari ka të drejtë, që të pranojë informata të detajizuara lidhur me: a) gjendjen e shëndetit të tij, përfshirë këtu edhe vlerësimin mjekësor (...); h) suksesin ose dështimin eventual të çfarëdo ekzaminimi ose intervenimi të përfunduar, përfshirë edhe rezultatet që dallojnë nga ato të pritura, si dhe shkaqet për këtë [...].”*
36. Paragrafi 1 i nenit 1 të Ligjit nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit përcakton: *“Qëllimi i këtij ligji është krijimi dhe funksionalizimi i programit për kompensim të viktimave të Krimit.”* Ndërsa neni 2 përcakton: *“Ky ligj rregullon të drejtën e kompensimit financiar të viktimave të veprave të dhunshme penale dhe të vartësve të tyre, autoritetet vendimmarrëse si dhe procedurat për realizimin e të drejtës për kompensim në situatat vendore dhe ndërkuftare.”* Më tutje Ligji në nenin 6 përcakton: *“Veprat e dhunshme të cilat hyjnë në kategorinë e veprave të kompensueshme sipas këtij Ligji janë:[...] veprat penale që bien brenda përkufizimit të dhunës në familje sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.”*
37. Neni 1 i Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 01/2017 për Mënyrën e Kompensimit Përfshirë edhe Llogaritjen e Kompensimit për Dëmtimet e Shumëfishta përcakton: *“Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i mënyrës së kompensimit përfshirë edhe procedurën e pranimit, trajtimit, shqyrtimit të kërkesave, llogaritjen dhe vendosjen për kompensimin e viktimave të krimit.”*
38. Neni 1, paragrafi 1, i Udhëzimit Administrativ nr. 12/2012 për Përcaktimin e Vendit dhe Mënyrës së Trajtimit Psikosocial të Kryesit të Dhunës në Familje përcakton: *“Ky Udhëzim Administrativ rregullon dhe përcakton vendin dhe mënyrën e zbatimit të trajtimit psikosocial ndaj kryerësit të dhunës në familje me qëllim të parandalimit apo nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.”* Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton: *“Trajtimi psikosocial i kryerësve të dhunës ka si qëllim ndërprerjen e dhunës, duke parandaluar sjellje të tjera të dhunshme, rritjen e vetë-kontrollit nga ana e kryerësit të dhunës si dhe në tejkalimin e situatave që do të mund të shpijnë në një sjellje të dhunshme, duke i ofruar këshillim kryerësve të dhunës, identifikim të origjinës së sjelljes së dhunshme dhe rritjen e përgjegjësisë të kryerësit të dhunës për sjelljen e tij të dhunshme.”*

Analiza ligjore

39. Kushtetuta, si akti më i lartë juridik, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Garantitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë, përfshirë këtu edhe institucionet policore, gjyqësore dhe shëndetësore.
40. Kushtetuta, në nenin 25, paragrafi 1, përcakton: "*Secili individ gëzon të drejtën për jetën.*" Nga ky paragraf shihet qartë se e drejta për respektimin e jetës së qytetarit gjendet në qendër të sistemit kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe e drejta për jetën (pacenueshmëria e saj) është e drejtë absolute e njeriut, e cila nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë, si dhe nuk lejohet shmangia nga kjo e drejtë. Avokati i Popullit vëren se Kushtetuta definon qartë se secili person ka të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që, përveç tjerash, kur bëhet fjalë për të drejtën e integritetit personal, për të drejtën shëndetësore dhe për të drejtën për jetë, shteti ka **detyrim pozitiv** t'i ndërmarrë të gjitha masat për ta mbrojtur pacenueshmërinë e integritetit fizik dhe shëndetësor të personave, veçanërisht kur rrezikohet integriteti dhe jeta e njeriut. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në Aktgjykimin KI. 41-12⁷, ka gjetur se kishte shkelje të së drejtës për jetë në rastet kur organet kompetente të shtetit nuk u ofronin mbrojtje të mjaftueshme qytetarëve të ekspozuar dhunës në familje dhe kur për këtë e kërkonin rrethanat e rastit. **Gjykata Kushtetuese theksoi se e drejta për jetë është e drejta më e rëndësishme prej të gjitha të drejtave njerëzore, nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera dhe sqaroi se ekzistojnë detyrime pozitive për organet e pushtetit që të ndërmarrin masa parandaluese dhe operative për ta mbrojtur jetën e të gjithë atyre që i janë ekspozuar rrezikut.**
41. Avokati i Popullit rikujton se, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: *Gjykata Evropiane*).
42. Neni 2 i Konventës paraqet detyrimet e përgjithshme të shtetit për ta mbrojtur të drejtën për jetë dhe përfshinë aspektet **pozitive dhe negative**: a) **detyrimin pozitiv** për ta mbrojtur jetën; dhe b) **detyrimin negativ** që të përmbahet nga marrja e paligjshme e jetës. Obligimi pozitiv imponon detyrime të **parandalimit dhe hetimit**. **Detyrimet e parandalimit** (shih rastin *Osmani kundër Britanisë së Madhe, i datës 28 shkurt 1998*) i obligojnë qeveritë e shteteve që t'i pengojnë dhe t'i luftojnë veprat penale. Nëse vërtetohet se qeveritë kishin njohuri, ose do të duhej të kishin njohuri në kohën e ekzistimit të rrezikut real dhe të drejtpërdrejtë për jetën e një personi të identifikuar, nga veprat penale të palëve të treta dhe **nëse nuk kanë ndërmarrë masa të duhura në**

⁷ Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Rasti KI 41/12, parashtues Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i njohur në publik si rasti **Diana Kastrati**.

kuadër të kompetencave të veta, të cilat, sipas një vlerësimi të arsyeshëm, mund të priteshin, në mënyrë që të shmangej rreziku për jetë, **të njëjtat duhet të jenë përgjegjëse për moszbatim të detyrimeve pozitive.**

43. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane, neni 3 i Konventës, mund të cenohet si nga keqtrajtimet e paramenduara, e gjithashtu edhe nga neglizhenca apo pasiviteti në ndërmarrjen e hapave specifikë ose mospajtimet e standardeve të duhura të përkujdesjes. Ky nen imponon si detyrime negative ashtu edhe detyrime pozitive, domethënë një detyrim për të mos kryer një veprë të caktuar, si dhe detyrimet për të ndërmarrë hapa pozitivë për t'u siguruar individëve respektimin e të drejtave të tyre dhe për t'i mbrojtur ata nga keqtrajtimi. Nisur nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane tek rastet e ofrimit të kujdesit shëndetësor, shihet qartë se shteti ka për detyrë të sigurojë sisteme të përshtatshme të punës dhe me punonjës mjaft të aftë për të mbrojtur jetën, p.sh. në spitale, të cilat duhet të marrin masa adekuate për mbrojtjen e jetës së pacientëve,⁸ të mos e mohojnë vënie në dispozicion të kujdesit shëndetësor (t'u sigurojnë kujdes shëndetësor)⁹ dhe duhet t'ua sigurojnë ilaçet e duhura (të përshtatshme).¹⁰ Gjykata gjeti shkelje të nenit 2 në rastin kur një fëmijë vdiq në ambulancë pasi nuk u pranua nga spitali dhe u transferua te institucionet tjera, për shkak të mungesës së pajisjeve të specializuara¹¹ dhe te rastet kur nga shkak i keqfunksionimit të departamenteve të spitalit erdhi deri te mungesa e kujdesit mjekësor urgjent, e cila përfundoi me vdekje. Prandaj edhe te ky rast gjykata gjeti se ky veprim përbën shkelje të nenit 2¹².
44. Bazuar në vendimet e Gjykatës Evropiane nga fushëveprimi dhe natyra e detyrës që të hetohen incidentet mortore/fatale janë të shpjeguara, në veçanti, në lëndën **Tanrikulu kundër Turqisë**, aktgjykimi i datës 8 korrik 1999, me ç' rast Gjykata Evropiane e ka vlerësuar që *obligimi që të hetohen rastet e vdekjes* nuk ka të bëjë vetëm me rastet e vdekjeve për të cilat përgjegjës kanë qenë zyrtarët e shtetit, por të gjitha ato raste të vdekjeve për të cilat autoritetet kanë qenë të informuara, domethënë, për të cilat kanë pasur njohuri. Autoritetet duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm/të domosdoshëm që të sigurojnë prova relevante (përfshirë edhe dëshmitë e dëshmitarëve okularë dhe provat e forenzikës), në mënyrë që hetimi të jetë i dobishëm dhe efikas. Prandaj, dështimi për t'u vazhduar rrjedha e qartë e ekzaminimit gjatë hetimeve mund të çojë në konstatimin e një shkeljeje të nenit 2.
45. Gjykata Evropiane gjatë interpretimit të nenit 2 të Konventës, në rastin **Branko Tomašić dhe të tjerët kundër Kroacisë**, i datës 15 janar 2009, lidhur me detyrimet pozitive analizon rastin kur një person ka realizuar kërcënimet e tij të mëparshme për të vrarë partneren e tij dhe vajzën e tyre të vogël. Ai kishte qenë i burgosur për pesë muaj, për shkak të kërcënimeve me vdekje që ia kishte bërë më herët familjes së vet, prandaj autoritetet urdhëruan masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim. Menjëherë

⁸ *Vo v Francës*

⁹ *Qipro v Turqisë*

¹⁰ *Panaiteescu v Rumanisë*

¹¹ *Asiye Genç v Turqisë*

¹² *Shiko Mehmet Şentürk dhe Bekir Şentürk v Turqisë*

pas lirimt të tij, ai vrau gruan e tij dhe fëmijën, para se të bënte vetëvrasje. Gjykata gjeti se autoritetet ishin në dijeni për seriozitetin e kërcënimeve, por dështuan në detyrimet e veta pozitive, para së gjithash për shkak të trajtimit të pamjaftueshëm psikiatrik duke konsideruar se ai zgjati shumë shkurtë, si dhe nuk ishte e qartë se a është trajtuar në të vërtetë dhe si duhet ky person. Gjykata Evropiane gjeti se nuk kishte asnjë vlerësim paraprak të rrezikut para lirimt të tij nga masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, kurse legjislacioni vendor nuk e ka lejuar vazhdimin e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik edhe pas mbajtjes së dënimit, gjë që sipas Gjykatës Evropiane paraqet shkelje të nenit 2 të Konventës. Një situatë shumë të ngjashme, të mos themi krejt identike, na paraqitet edhe në rastin që po e trajton ky Raport, pasi që personi H. K. kishte çrregullime kronike psikiatrike, kishte trajtim jo të mjaftueshëm/duhur psikiatrik dhe sulmet e tij fizike të kohëpaskohshme ndaj familjarëve të tij ishin kthyer në shqetësim serioz për familjarët e tij duke e rrezikuar jetën dhe pronën e tyre dhe nga dëshmitë e siguruara shihet se, së paku nga viti 2003 e tutje, autoritetet ishin në dijeni për seriozitetin e kërcënimeve të personit H. K. ndaj familjarëve të tij, por dështuan në detyrimet e veta pozitive, që ta ruajnë jetën e qytetareve dhe e gjithë ngjarja përfundoi me vrasje të trefishtë.

46. Konventa (neni 5, paragrafi 1) e lejon ndalimin si të ligjshëm në rastet e ndalimit të: *“Personave për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, të personave të sëmurë mendërisht, të alkoolizuarve ose toksikomanëve apo rrugaçëve”*; dhe sa i përket arsyes se pse personat që bëjnë pjesë në disa nga këto kategori mund të ndalohen, Gjykata Evropiane u shpreh: *“Jo vetëm që ata duhet të konsiderohen me raste si të rrezikshëm për sigurinë publike, por gjithashtu se vetë interesat e tyre mund të kërkojnë ndalimin përkatës”* (shih rastin *GUZZARDI kundër ITALISË* nr. *7367/76*). Kodi Penal i Republikës së Kosovës përcakton masat e trajtimit të detyrueshëm, të cilat mund t'i shqiptohen kryerësit që nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi esencialisht të zvogëluar mendore, apo është i varur nga droga ose nga alkooli. Sipas Kodit, këto masa janë: **trajtimi** i detyrueshëm psikiatrik **me ndalim** në institucionin e kujdesit shëndetësor; **trajtimi** i detyrueshëm psikiatrik **në liri**; dhe **trajtimi** me anë të **rehabilitimit të detyrueshëm** të personave të varur nga droga ose nga alkooli. Kodi sqaron më tutje se gjykatat mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri personit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të paaftësisë mendore ose të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se ekziston rrezik serioz se kryerësi sërish do të kryejë veprë penale, prandaj trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale, si dhe kur konstaton se trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz, veprime këto që nuk janë ndërmarë në asnjë periudhë ndaj personit H. K.
47. Në rastin *Kontrová kundër Sllovakisë* nr. *7510 04*, viktimja e dhunës në familje paraqiti një ankesë penale kundër bashkëshortit të saj për sulm fizik ndaj saj, pasi që bashkëshorti e rrihte atë me një kabllo elektrike. Pas kësaj, ajo, e shoqëruar nga bashkëshorti i saj, shkoi te autoritetet dhe u përpoq ta tërhiqte ankesën e saj penale dhe ndryshoi ankesën në mënyrë të tillë që veprimet e supozuara të bashkëshortit të saj u trajtuan si kundërvajtje

dhe ajo nuk kërkoi veprime të mëtejshme. Dy muaj pas kësaj ngjarjeje, burri i saj e vrau të bijën dhe djalin e saj, të lindur në 1997 dhe më 2001. Para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, parashtruesja pretendonte se policia, e vetëdijshme për sjelljen abuzive dhe kërcënuese të bashkëshortit të saj, nuk kishte ndërmarrë veprime të duhura që ta mbrojë jetën e fëmijëve të saj. Ajo më tej u ankua se nuk ishte e mundur që ajo të merrte kompensim. Gjykata Evropiane konsideroi se kishte pasur shkelje të nenit 2 të Konventës, lidhur me dështimin e autoriteteve për të mbrojtur jetën e fëmijëve të parashtrueses dhe vuri në dukje se situata në familjen e saj ishte e njohur nga policia vendore duke pasur parasysh ankesën penale të nëntorit 2002 dhe thirrjet telefonike emergjente në dhjetor 2002. Në përgjigje, sipas ligjit në fuqi, policia kishte qenë e detyruar që pas ankesës penale të fillojë menjëherë një hetim penal dhe procedurë penale kundër burrit të saj, të mbajë një regjistër të duhur të thirrjeve emergjente dhe të këshillojë ndryshimin e ardhshëm të situatës dhe të ndërmarrin veprime në lidhje me pretendimin se burri i parashtrueses kishte një armë gjahu dhe kishte kërcënuar se do ta përdorte atë. Si përfundim, siç kishin vërtetuar gjykatat vendase dhe qeveria sllovaqe, kishte pranuar se policia kishte dështuar në detyrimet e saj dhe pasoja e drejtpërdrejtë e këtyre dështimeve kishte qenë vdekja e fëmijëve të parashtrueses. Gjykata Evropiane më tutje konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 13 (e drejta për një zgjidhje efektive) të Konventës, pasi që parashtruesja duhej të kishte qenë në gjendje të kërkonte kompensim për dëmin jomaterial, por asnjë mjet i tillë nuk kishte qenë në dispozicion të saj.

48. Në rastin *Durmaz kundër Turqisë* (nr. 3621/07), ankuesja pretendoi se hetimi për vdekjen e vajzës së saj nga autoritet turke kishte qenë joefektiv dhe Gjykata Evropiane, pas trajtimit të këtij rasti, gjeti se kishte shkelje të nenit 2 të Konventës në aspektin e saj procedural, për shkak të dështimit të autoriteteve turke për të kryer një hetim efektiv për vdekjen e vajzës së aplikantes. Gjykata Evropiane vuri në dukje (si në rastin *Opuz*) se dhuna në familje preku kryesisht gratë dhe se pasiviteti gjyqësor i përgjithshëm dhe diskriminues në Turqi krijoi një klimë që ishte e favorshme për dhunën në familje. Përshtatshmërisht mund të konsiderojmë se, pavarësisht mekanizmave të krijuar nga shteti ynë kundër dhunës në familje, në shumë raste ato po dëshmonen joefektive dhe joefikase, pasi që dhuna në familje po prek kryesisht gratë dhe fëmijët.
49. Në rastin e *Talpis kundër Italisë* (nr.41237/14), lidhur me dhunën në familje, së cilës iu ekspozua nëna e dy fëmijëve (znj. Talpis) dhe që rezultoi me vdekjen e djalit të saj dhe me vrasja në tentativë ndaj saj, Gjykata Evropiane gjeti se ka pasur shkelje të nenit 2, për shkak të vrasjes së djalit të saj dhe tentim-vrasjes ndaj saj dhe se në rastin konkret ka pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor, degradues dhe poshtëruës), për shkak të dështimit të autoriteteve në detyrimin e tyre për të mbrojtur znj. Talpis kundër akteve të dhunës në familje dhe se ka pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenet 2 dhe 3 të Konventës. Gjykata Evropiane konstatoi se autoritetet kombëtare dështuan të ndërmarrin veprime efikase ndaj ankesës së parashtruar nga znj. Talpis dhe krijuan një situatë të pandëshkueshmërisë së kryerësit të dhunës në familje, e cila dërgoi në përsëritjen e akteve të dhunës, që më pas çuan në tentim-vrasjen e znj. Talpis dhe vdekjen e djalit të saj. Prandaj, autoritetet italiane kishin dështuar në detyrimin

e tyre për të mbrojtur jetën e personave në fjalë. Gjykata Evropiane gjeti se znj. Talpis kishte jetuar me fëmijët e saj në një klimë të dhunës serioze, e mjaftueshme për t'u kualifikuar si keqtrajtim, dhe se mënyra në të cilën autoritetet i kishin kryer procedurat penale vunë në dukje pasivitetin gjyqësor, i cili ishte i papajtueshëm me nenin 3 të Konventës. Së fundmi, Gjykata Evropiane gjeti se znj. Talpis ishte viktimë e diskriminimit, si një grua, në llogari të mosveprimit të autoriteteve, të cilat e kishin nënvlerësuar dhunën në fjalë, e cila situatë në mënyrë analoge na paraqitet te rasti që po e trajton ky raport për familjen Krasniqi. Neni 3 i Konventës gjithashtu ia imponon detyrimin shtetit që *askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve dhe trajtimeve çnjerëzore ose degraduese*. Konventa duhet kuptuar nga këndvështrimi i "objektivit dhe qëllimit" të saj, ashtu siç është parashtruar nga Gjykata Evropiane, për t'i mbrojtur qeniet njerëzore individuale brenda kuptimit të vlerave të një shoqërie demokratike, që nënkupton se dispozitat e saj duhet të interpretohen e zbatohen për të siguruar mbrojtje praktike dhe efektive. Prandaj neni 3 i Konventës përmban aspektet substanciale dhe procedurale, si për shembull detyrimin për të hetuar mbi supozimet *prima facie* ndaj torturës së ushtruar e trajtimeve të tjera çnjerëzore.

50. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton qartë se ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me aplikimin e masave të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes që janë viktimë të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Tutje, Ligji ka për qëllim trajtimin e kryerësve të dhunës në familje, lehtësimin e pasojave të dhunës, shqiptimin e masave mbrojtëse (trajtimi psikosocial mund t'i shqiptohet kryerësit të dhunës në familje në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese), me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme të kryerësit apo nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje. Po ashtu, Ligji përcakton masa mbrojtëse të largimit nga banesa, nga shtëpia apo nga hapësira tjetër e banimit, që i shqiptohet personit që ka kryer dhunë ndaj anëtarit të familjes me të cilin jeton në banesë, në shtëpi apo në ndonjë hapësirë tjetër banimi, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje, veprime këto që nuk kanë ndodhur ndaj personit H. K., prandaj ka ardhur deri te përsëritja e situatave të dhunës të cilat më pas u shndërruan në tragjedi.
51. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton qartë se vendimi për urdhër mbrojtje, ose për urdhër mbrojtje emergjente, ekzekutohet menjëherë me vendim përkatës, i shqiptuar nga gjykata kompetente dhe u dërgohet menjëherë kryerësit të dhunës në familje, Policisë së Kosovës, qendrave për punë sociale, si dhe palëve të tjera në procedurë, duke specifikuar se Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, me Ministrinë e Drejtësisë, me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me Ministrinë e Kulturës të Rinisë dhe të Sportit dhe me atë të Arsimit, është përgjegjëse për mbështetjen dhe për ngritjen e strukturave ndihmëse dhe të infrastrukturës së nevojshme, që shërben për mbështetjen dhe për plotësimin e nevojave të personave ndaj të cilëve është ushtruar dhuna në familje, përfshirë këtu asistencën sociale dhe shërbimet mjekësore, në pajtim me legjisllacionin në fuqi. Bazuar në hetimet e këtij rasti, kemi gjetur se, përveç shqiptimit të

urdhrit mbrojtjes nga gjykata, nuk është ndërmarrë asnjë lloj procedure tjetër në kuptim të mbështetjes dhe ngritjes së strukturave ndihmëse, apo infrastrukturës së nevojshme, për mbështetjen dhe për plotësimin e nevojave të personave ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje, përfshirë këtu asistencën psiko-sociale nga QPS-ja dhe shërbimet e tjera, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Nga ana tjetër, këto veprime të institucioneve kanë munguar edhe ndaj kryerësit të dhunës H. K., dhe si rrjedhojë e mostrajtitimit të duhur të këtij personi, e gjithë ngjarja përfundoi me tri viktima.

52. Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare e përkufizon “*Person në Nevojë*” cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale, për shkak të, përveç tjerash, edhe të sëmundjes mendore. Tutje Ligji përcakton se nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se personit të rrezikuar i mungon zotësia për të vepruar në emër të vet dhe se është e nevojshme për ta mbrojtur të rriturin nga rreziku serioz, QPS-ja duhet ta paraqesë në gjykatë kërkesën për një urdhër kujdestarie në mënyrë që ta mbrojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e personit për të cilin jepet urdhri. Ligji përcakton se gjykata mund të vendosë mbikëqyrjen e rrethanave të jetesës së të rriturit të rrezikuar, nga ana e një profesionisti të caktuar nga QPS-ja apo ta urdhërojë QPS-në për të vendosur të rriturin, i cili mendërisht nuk është i aftë për t’u kujdesur për veten, në një objekt të përshtatshëm rezidencial. Nga ajo që u tha më lart, (shih paragrafin 46, të këtij raporti) shihet qartë se kur bëhet fjalë për personat me sëmundje psikike, si në rastin e personit H. K., Gjykata Evropiane kishte konstatuar se këta persona *Jo vetëm që duhet të konsiderohen si të rrezikshëm për sigurinë publike, por gjithashtu se vetë interesat e tyre mund të kërkojnë ndalimin përkatës*. Prandaj, sikur të kishte një vlerësim paraprak nga ana e autoriteteve lidhur me personin H. K. dhe të zbatohet ligji i aplikueshëm, sigurisht se kjo çështje do të parandalohet dhe nuk do të kishte përfundim tragjik.
53. Ligji për Shëndetin Mendor përcakton sheshazi se ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore. Sipas Ligjit, ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullim mendor duhet të bëhet në një ambient sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur maksimalisht zhvendosjen nga mjedisi familjar e për ta lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social duke përcaktuar se krijimi i lehtësirave duhet të bëhet përmes programeve dhe projekteve që implementohen nga organet kompetente për këta persona dhe familjet e tyre, me qëllim të përfshirjes së tyre në jetën shoqërore. Ligji përcakton se ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime mendore bëhet nga **ekipe shumëdisiplinore**¹³, që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit. Nga hetimi i këtij rasti rezultoi se QPS-ja në Prishtinë dhe institucionet përkatëse psikiatrike nuk janë marrë fare me trajtimin shëndetësor/psikiatrik të personit H. K. Po ashtu, nga hetimi *Ex Officio* i këtij rasti

¹³ Ligji i përkufizon ekipet multidisiplinore si: “*Ekipet e përbëra nga specialistë të disa fushave si mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, këshilltarë psikosocial, terapeutë të punës, logopedë, terapeutë zhvillimi apo profesionist të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor.*”

rezultoi se organet e ndjekjes, apo organet e tjera, nuk kërkuan në asnjë fazë nga gjykata që të kërkojë nga organet kompetente shëndetësore ekspertizë lidhur me gjendjen e shëndetit mendor të personit H. K., dhe më pas të mund të lëshonte ndonjë urdhër për trajtim të detyrueshëm psikiatrik në ndalim apo në liri.

54. Udhëzimi Administrativ për Përcaktimin e Vendit dhe Mënyrës së Trajtitit Psikosocial të Kryesit të Dhunës në Familje, i cili buron nga Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, përcakton qartë se ka për qëllim të rregullojë dhe të përcaktojë vendin dhe mënyrën e zbatimit të trajtimit psikosocial ndaj kryerësit të dhunës në familje me synim të parandalimit apo nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje. Tutje Ligji thekson se trajtimi psiko-social i kryerësve të dhunës ka si qëllim ndërprerjen e dhunës, duke parandaluar sjellje të tjera të dhunshme, rritjen e vetëkontrollit nga ana e kryerësit të dhunës si dhe në tejkalimin e situatave që do të mund të shpijnë në një sjellje të dhunshme, duke i ofruar këshillim kryerësve të dhunës, identifikim të origjinës së sjelljes së dhunshme dhe rritjen e përgjegjësisë të kryerësit e dhunës për sjelljen e tij të dhunshme. Ky Udhëzim u dedikohet kryerësve të dhunës në familje të cilëve gjykata ua shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm të rehabilitimit psiko-social dhe kryesisht ndaj personave kryerës të dhunës në familje me anamnezë/diagnozë psikiatrike pozitive, të cilët duhet të trajtohen në institucione shëndetësore. Në rastin konkret shihet qartë se personi H. K. i ka plotësuar parakushtet e nevojshme për t'iu shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm të rehabilitimit psiko-social si kryerës i dhunës në familje, me anamnezë/diagnozë psikiatrike pozitive, por ka munguar azhurnimi dhe kërkesa e organeve kompetente dhe e vetë gjykatës për një veprim të tillë, pavarësisht faktit se viktima e dhunës në familje/pala e mbrojtur kishte deklaruar në polici se bashkëshorti i saj H. K. është i sëmurë mendor dhe po përdor terapi nga psikiatri, pasi që tri vjet para kësaj ngjarjeje kishte tentuar të hidhej nga banesa dhe të vetëvritej¹⁴.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

55. Avokati i Popullit, në bazë të të gjeturave dhe fakteve të mbledhura, si dhe analizimit të ligjeve relevante, të cilat e përcaktojnë të drejtën për jetë dhe detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën për jetë, **konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut**, meqë autoritet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore, e as standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës, kundrejt ndërmarrjes së veprimeve konkrete për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe trajtimit psikiatrik të personit me çrregullime kronike psikiatrike dhe, si pasojë e gjendjes së krijuar nga neglizhenca e autoriteteve përgjegjëse, kishte implikime të drejtpërdrejta në humbjen e jetës së tre personave.
56. Për më tej, qysh në fillim duhet vënë në pah se është përgjithësisht e pranuar se në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhuna në familje ngre shumë çështje lidhur me të drejtat e njeriut. Në përgjithësi, të drejtat e njeriut dhe shëndeti mendor ndajnë të njëjtin objektiv për promovimin dhe mbrojtjen e së drejtës për mirëqenie të të gjithë

¹⁴ Shih deklaratën e Hysnije Krasniqit dhënë në Stacionin Policor “Jugu” në Prishtinë, më 7 gusht 2017, Rasti 2017-AD-2252.

individëve. Deklarata e Vjenës dhe Programi i Veprimit, aprovuar në Konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut, më 1993, ka konfirmuar se të gjitha të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme, të ndërlidhura dhe të ndërvarura.¹⁵ Parimet kryesore të të drejtave të njeriut, që janë esenciale për një reagim efektiv të shteteve kundër dhunës ndaj individit dhe abuzimeve me të drejtat e njeriut, mund të gjenden në disa instrumente ndërkombëtare: 1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; 2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; 3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; 4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; 5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; 6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; 7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; 8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëuese; 9) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore etj. Për më tepër, janë miratuar një numër i konsiderueshëm i konventave dhe deklaratave që veçanërisht, apo në përgjithësi, njohin dhe mbrojnë të drejtat e njeriut, veçanërisht kundër dhunës në familje, siç është Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, e miratuar në Stamboll, më 11 maj 2011, e njohur si Konventa e Stambollit.

57. Avokati i Popullit konstaton se Kosova ka një kornizë të fortë kushtetuese, si dhe një numër relevant ligjesh e politikash, strategjish dhe mekanizmash nacionalë dhe lokalë kundër dhunës në familje dhe, në këtë kontekst, janë bërë disa arritje të mëdha. Megjithatë, progresi nuk ka qenë i barabartë me një sërë sfidash që pengojnë realizimin adekuat të këtyre ligjeve, strategjive e mekanizmave dhe këto kanë të bëjnë me sistemin në përgjithësi, përfshirë implementimin e dobët të ligjeve dhe politikave, koordinimi i dobët mes sektorëve dhe mes autoriteteve, monitorim dhe llogaridhënie të dobët, veprime këto që po përcillen me mosndëshkime dhe moskompensim të viktimave të dhunës, gjë që shkel jo vetëm të drejtat e njeriut, por që vepron edhe si një zhgënjim në kërkimin e shërbimeve nga autoritetet publike në Kosovë.
58. Avokati i Popullit konstaton se autoritetet përgjegjëse, me mosveprimin e tyre në përputhje me obligimet e tyre kushtetuese dhe ligjore për ta trajtuar çështjen e kryerësit të dhunës në familje (personit H. K.), kanë cenuar drejtpërdrejt të drejtat individuale të personave të tjerë të familjes Krasniqi, të garantuara me nenet 25, 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenet 2, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane. Si rrjedhojë e kësaj, parimi i shtetit të së drejtës, si parim themelor i Kushtetutës dhe i Konventës, obligon organet shtetërore që ta respektojnë/zbatojnë legjisllacionin e aprovuar nga legjislativi i vendit. Garancitë kushtetuese për të drejtat e njeriut janë vlera themelore të shoqërisë demokratike që i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë, sepse këto vlera janë baza themelore për funksionimin e shtetit dhe të së drejtës, si dhe janë parakusht i respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve. Gjykata Evropiane, në praktikën e saj, thekson: “Do të ishte në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, nëse do t'i lihej ndonjë diskrecion ligjor ekzekutivit.

¹⁵ Shih : A/CONF.157/24 (Part I), chap. III, World Conference on Human Rights in Vienna on 25 June 1993.

Rrjedhimisht, ligji duhet të tregojë qëllimin e çdo diskrecioni të tillë dhe mënyrën e ushtrimit të tij me qartësi të mjaftueshme, për t'i dhënë mundësi individit në mbrojtje adekuate kundër arbitraritetit.” (Shih Vendimin e GjEDNj-së në rastin Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar, i datës 2 gusht 1984 § 68).

59. Avokati i Popullit rikujton se, si pjesë përbërëse e parimit të sigurisë juridike, garantohet edhe parimi i pritjes legjitime. Në bazë të doktrinës së pritjes legjitime, ata të cilët veprojnë me mirëbesim dhe në përputhje me ligjin, nuk duhet të jenë të indinjuar nga pritjet e tyre legjitime. Kjo doktrinë nuk gjen zbatim vetëm në procedura të ligjdhënies, por edhe në nxjerrjen e vendimeve në rastet individuale nga autoritetet publike. Po ashtu, siguria juridike nënkupton që ligji të jetë i qartë dhe i zbatueshëm në praktikë¹⁶. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane (shih rastet *Kopecky v. Slovakia*, *Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, par. 45-52*; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.)*, nr. 39794/98, par. 73, GjEDNj 2002-VII), “*pritja legjitime*” duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore ose në akte ligjore. Në rastin konkret, pritja legjitime për mbrojtje nga dhuna në familje ishte bazuar ekskluzivisht në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, në Ligjin për Barazi Gjinore, në Kodin Penal, si dhe në një mori të akteve të tjera normative të zbatueshme në Kosovë, por të gjitha mjetet juridike në dispozicion ishin treguar si mjet juridik i papërshtatshëm dhe joefektiv në rastin që po e trajton ky raport. E gjithë kjo gjendje në lidhje me rastin kishte ardhur, pasi që autoritetet kompetente kishin përjashtuar vlefshmërinë e legjislacionit të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe kështu ishte krijuar një situatë e “*nudum ius*”, ku ligjet ekzistojnë por nuk zbatohen.
60. Në shtjellimin e më tutjeshëm të këtij rasti, Avokati i Popullit konstaton se kryerësi i dhunës në familje nuk ishte trajtuar në aspekt të mirëqenies së shëndetit mendor të tij dhe ka siguruar prova të mjaftueshme se dhuna në familje nga personi H. K. kishte filluar së paku 16 vjet para se të ndodhte vrasja dhe autoritetet përgjegjëse nuk ishin marrë seriozisht me rastin në asnjë fazë kohore. Prandaj personi H. K. vazhdimisht kishte mbetur i pa trajtuar në aspektin shëndetësor dhe penal, dhe kështu, i njëjti kishte realizuar kërcënimet e tij. E gjithë kjo ndodhi për shkak të neglizhencës institucionale. Më tej, Avokati i Popullit konstaton se mungesa e psikologut në QPS-në nr. 1 në Prishtinë dhe mostrajtimi psiko-social i kryerësit të dhunës në familje dhe viktimës së dhunës në familje, siç ndodhi në rastin konkret, kishte implikime të drejtpërdrejta në epilogun e rastit. Për më shumë, Ligji për Shëndetin Mendor përcakton qartazi se ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime mendore duhet të bëhet nga **ekipe shumëdisiplinore**, të cilat përbëhen nga specialistë të disa fushave, si mjekë, infermierë, **psikologë**, punonjës socialë, këshilltarë psiko-socialë, terapeutë të punës, logopedë, terapeutë zhvillimi apo profesionistë të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit.

¹⁶ EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION)
REPORT ON THE RULE OF LAW Adopted by the Venice Commission at its 86th plenary session. (Venice, 25-26 March 2011) (44-51).

61. Në këtë kuptim, Avokati i Popullit rithekson se detyrimi i organeve shtetërore është jo vetëm të përmbahen nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, por t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme për mbrojtjen e jetëve të individëve, që të sigurojnë të drejtën për jetë, sidomos ndaj kategorive të ndjeshme, në rastin konkret ndaj grave dhe fëmijëve të rrezikuar nga dhuna në familje. Bazuar në disa nga ngjarjet që kanë ndodhur në vendin tonë (shih paragrafin 40 të këtij raporti), është vërtetuar se, në disa raste, organet shtetërore nuk kanë arritur të sigurojnë mbrojtjen e nevojshme ndaj viktimave të dhunës në familje dhe rastet kanë përfunduar me vrasje. Sigurisht se vrasjet nga dhuna në familje përfundimisht nuk mund eliminohen plotësisht në asnjë shtet të botës, por kur rastet gjinden në procedurë gjyqësore dhe kur janë situata ku ka indikacione se raportet janë të acaruar me indikacione se mund të ketë kërcënime serioze për jetën, atëherë puna e policisë, e sistemit gjyqësor, e sistemit prokurorial, e QPS-ve, e sistemit shëndetësor etj., duhet të vijë në shprehje dhe nëse ka mosveprim apo pengesa në procedimin adekuat të rastit apo zbatimin e ligjit nga ana e tyre (si në rastin konkret), atëherë shteti mbahet përgjegjës për shkeljen që i është bërë viktimave të krimit dhe familjarëve të viktimave të tyre u takon **kompensimi**.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: "*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*" Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: "*(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla (...)*"; si dhe: "*të rekomandojë (...) nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.*" (Neni 18, paragrafi 1.7).

Prandaj, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

1. Qeverisë së Republikës së Kosovës:

- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore (sipas Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit), përmes organeve të tjera vartëse, t'i kompensojë familjarët e viktimave të krimit në familjen Krasniqi.*

2. Policisë së Kosovës:

- *Të mbajë një regjistër të thirrjeve emergjente për rastet e recidivistëve të akteve të dhunës në familje dhe t'i japin prioritet trajtimit të këtyre rasteve.*

3. Ministrisë së Shëndetësisë:

- *Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës të nxjerrë një udhëzim, me të cilin do t'i njoftojë të gjitha institucionet shëndetësore për detyrat dhe përgjegjësitë që kanë kur përballen me raste të trajtimit të personave me çrregullime mendore, si dhe t'i obligojnë ato që të veprojnë në përputhje me nenin 19, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor.*

4. Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial:
 - *Gjatë shqyrtimit të rasteve për urdhër mbrojtje, të verifikohet gjendja psikike e ushtruesit të dhunës në familje dhe të vendoset në përputhje me nenin 20, paragrafi 2.2, të Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor.*
5. Komunës së Prishtinës:
 - *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore dhe në bashkëpunim me autoritetet kompetente, t'i ndër marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të sigurojë prezencën e psikologut në të gjitha QPS-të në Prishtinë, në mënyrë që të veprojnë në përputhje me nenin 16, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor.*
6. Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave:
 - *Në pajtim me autorizimet ligjore dhe në bashkëpunim me organet gjegjëse, ta rrisë numrin e mbrojtësve në ZMNV-në e Prishtinës.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokat i Popullit